

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-001/14**

**Prishtinë, 6 Tetor 2015**

Në çështjen juridike të

**Ž. N. E.**

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtare, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013 të datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin. 29812), pas shqyrtimit të mbajtur më 6 Tetor 2015, lëshoi këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e palës ankuese Ž. N. E.e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013 të datës 18 prill 2013.
2. Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/199/2013 i datës 18 prill 2013 për sa i përket KPA29812.

### Përmbledhje e çështjeve procedural dhe faktike:

1. Më 30 prill 2007, Ž. N.E. si anëtar i familjes së ngushtë të nënës së tij M. .N. S., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr. 2589 me adresë Peka Tepavceva nr.12 në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ai ka deklaruar se kishte humbur pronësinë mbi ngastrën për shkak të konfliktit të armatosur, duke e cekur 28 qershorin 1999 si datën e humbjes, dhe si pasojë kishte ardhur deri tek uzurpimi i pronës së kërkuar.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i ankesës ka dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
  - Fletën Poseduese nr.645, të datës 14 shtator 2006, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Ferizajt; M. N. S. e regjistruar si pronare e pronës së kërkuar;
  - Certifikatën e dëshmisë nr.43-437-1516, të datës 15.09.2006 dhe të lëshuar nga ATK qendra regjionale Prishtinë që tregon se pala kërkuese ka paguar taksat deri më 31 dhjetor 1998;
  - Certifikatën e lindjes nr. 200-4846/06 të datës 2006 e lëshuar nga komuna e Ferizajt; kjo certifikatë vërteton se pala kërkuese është i biri i N. E. dhe M. S.;
  - Deklarata e dy dëshmitarëve: ata deklarojnë se M. S. dhe M. S. janë personi i njejet dhe se Ž. E.është i biri i saj. Kjo deklaratë, është verifikuar nga Gjykata e trete e Beogradit, Serbi me datën 29 janar 2008 si OV.nr.710/08.
3. Njoftimi fizik i pronës së kërkuar është bërë më 16 janar 2008. Prona në atë kohë ka qenë shtëpi e pabanuar.

4. Kërkesa nuk është e kontestuar, sepse asnjë person nuk iu ka drejtuar AKP-së si palë përgjegjëse në kërkesë.
5. Nga Raportit të Konsoliduar të Verifikimit të datës 7 shkurt 2013, rezulton se ekipi verifikues i AKP-së ka gjetur dhe certifikatën e lindjes me nr. 43-437-1516, të datës 15.09.2006, si dhe deklaratën OV.nr.710/08 të datës 29 janar 2008 dhe i ka verifikuar pozitivisht. Ekipi i verifikimit i AKP-së ka konstatuar më 9 janar 2008 dhe 5 maj 2011 se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të B. I.. Ekipi verifikues sipas detyrës zyrtare i ka shtuar dosjes këto dokumente:
  - Certifikata e pronës së paluajtshme nr.UL-72217092-00644, të datës 30 mars 2011 e lëshuar nga Zyra e Kadastrit në Ferizaj; B. I.; ku vërtetohet se B. I. është i regjistruar në këtë certifikatë si pronar i ngastrës së kërkuar;
  - Kontrata mbi shitblerjen e pronës së paluajtshme të datës 14 nëntor 2001, e lidhur në mes të M. E. S. si shitëse, dhe B.I. si blerës; nga kjo kontratë, pronësia mbi pronën e kërkuar ishte bartur përmes transaksionit ligjor tek blerësi. Kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën Themelore të Ferizajt me datën 15 janar 2001 me nr.1309/01.

AKP gjithashtu konstaton se të dhënat kadastrale janë të përditësuara bazuar në këtë kontratë.
6. KKPK-ja me Vendimin KPPC/D/R/199/2013 të datës 18 prill 2013, e hodhi poshtë kërkesën me arsyetimin (në paragrafin 10 dhe 23 në Vendimin Grupor) se pala kërkuuese ka dështuar të paraqes argumente se në kërkesën e tij janë përfshirë rrethana të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur 1998-1999.
7. Vendimi i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës Ž. N.E. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) më 29 gusht 2013. Kurse ai kishte paraqitur ankesë kundër këtij vendimi me datën 13 shtator 2013.

#### **Pretendimet e palës ankuese:**

8. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKPK-së me arsyetimin se vendimi mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe bazohet në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Ai pohon se tjetërsimi i pretenduar i pronës së kërkuar nga e ëma e tij është i rremë. E ëma e tij nuk ka qenë pronare e shtëpisë së dytë të cilën ai vet e kishte ndërtuar në pronën e kërkuar por ka qenë pronare e objektit të dytë. Prandaj, e ëma e tij nuk ka mundur të tjetërsoj diçka që nuk e ka pasur në posedim.

**Arsyetimi ligjor:***Pranueshmëria e ankesës*

9. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve e paraparë me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

*Juridiksioni*

10. Pas shqyrtimit të dosjes së lëndës dhe pretendimeve së palës ankuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme duhet të jep një përgjigje nëse KKKPK ka juridiksion të vendos në lidhje me kërkesën në fjalë
11. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr.03/L-079, KKKPK-ja ka kompetenca të zgjidh kërkesat pronësore në lidhje me pronë private të paluajtshme, kërkesa këto të cilat kanë të bëjnë me të drejtat pronësore e që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave të ndërlidhura drejtpërsëdrejti ose të cilat rrjedhin nga konflikti i armatosur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
12. Lidhur me këtë çështje, AKP-ja konstaton se pronari i pronës së ankuar ka qenë e ëma e palës ankuese dhe se ajo ia kishte shitur pronën një personi të tretë, Beqir Ismajlit, në vitin 2001. Në fletën poseduese nr.645 të datës 14 shtator 2006, prona ishte e regjistruar në emër të së ëmës së tij. AKP-ja e ka gjetur sipas detyrës zyrtare certifikatën për pronën e paluajtshme nr. UL-72217092-00644 e datës 30 mars 2011, ku B. I. evidentohet si pronar aktual i pronës së kërkuar. Ndryshimet gjatë regjistrimit të pronësisë së pronës së kërkuar ishin bërë bazuar në Kontratën e Shitblerjes Vr.nr.1309/01, e lidhur me datën 14 nëntor 2001 në mes të ëmës së palës ankuese dhe Beqir Ismajlit. AKP-ja, sipas detyrës zyrtare, ka gjetur Kontratën e Shitblerjes dhe si të tillë e ka verifikuar pozitivisht, prandaj të njëjtën e ka shpallur valide. Në ankesë, pala ankuese nuk i konteston këto të gjetura të AKP-së.
13. Fakti që e ëma e palës ankuese e kishte shitur pronën në vitin 2001 nënkupton se ajo deri atëherë pas përfundimit të konfliktit i kishte ushtruar të drejtat e saj pronësore. Pasi e ëma i ka ushtruar të drejtat e saj pronësore pas konfliktit ky kusht për juridiksion nuk është përmbushur. Prandaj përgjigja në çështjen e ngritur nëse KKKPK ka juridiksion apo jo del të jetë negative. KKKPK-ja me të drejtë ka hedhur poshtë kërkesën pikërisht për këtë arsye.

14. Pala ankuese thekson se për herë të parë në letrën e vet të ankesës kërkon përmes saj konfirmimin e së drejtës pronësore mbi objektin e dytë, në pronën e kërkuar. Ky pretendim nuk shpie drejt aprovimit të kësaj ankese. Neni 12.11 i Ligjit nr.03/L-079 e ndalon palën ankuese të del me fakte të reja në ankesë kur ai ka mund t'i këtë të ditura këto fakte gjatë procedurave para AKP/KKPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme nuk e merr parasysh këtë pretendim në këtë ankesë. Përveç kësaj, pala ankuese nuk ia ka arritur të dorëzoj ndonjë dëshmi bindëse (të argumentueshme) lidhur me këtë pretendim.
15. Gjykata Supreme konkludon se vendimi i atakuar nuk përmban asnjë shkelje thelbësore apo ndonjë zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale dhe procedurale.
16. Gjykata Supreme, nga sa u përmend më lart, vlerëson se ankesa është e pabazuar. Prandaj, në bazë të asaj që u cek me lart dhe në pajtim me dispozitat e nenit 13.3 pika c të Ligjit 03/L-079 Gjykata vendosi sinë dispozitiv.

#### **Këshillë ligjore**

17. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it**